



VENDIMI I PRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 11 dhjetor 2020

Lënda nr. 2016-22

Radmila Šapić

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli"), i mbledhur më 11 dhjetor 2020, me anëtarët:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës për lëndën e lartcekur, e cila është parashtruar në pajtim me Veprimin e përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin e llogaridhënies të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Rregulloren e punës së Panelit, të ndryshuar më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike në pajtim me Rregullën 13(3) të Rregullores së punës së Panelit, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa në lidhje me këtë rast është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Përmes letrës së datës 1 korrik 2016, Paneli e informoi EULEX-in Kosovë ("Misioni") se ky rast është regjistruar në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli kërkoi nga ankuesja informata shtesë.
4. Më 20 shtator 2017 dhe 17 tetor 2017, Paneli dërgoi edhe dy kërkesa të tjera për informata shtesë përmes përfaqësuesit për familjet serbe nga Qendra Burimore për Personat e Zhdukur, një OJQ me seli në Prishtinë. Ankuesja nuk ka dorëzuar asnjë informatë shtesë.

5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli dërgoi një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve tek shëfja e atëhershme e Misionit dhe e ftoi atë për të dhënë përgjigje dhe vërejtje me shkrim ndaj ankesave më së voni deri më 26 janar 2018.
6. Misioni, përmes një letre të datës 4 janar 2019, kërkoi sqarime rreth disa pikëve në lidhje me formën e ankesës dhe lidhjen mes ankueses dhe personave të përmendur në ankesë.
7. Përmes një letre të datës 17 janar 2019, Misionit prapë iu kërkua që të jepte përgjigje ndaj pyetjeve deri më 16 shkurt 2019.
8. Përmes një letre të datës 31 janar 2019, Paneli i kërkoi ankueses që të rregullonte çështjet në lidhje me formën e ankesës dhe të sqaronte lidhjen e saj me personat e përmendur në ankesë. Ankuesja u përgjigj më 7 shkurt 2019.
9. Përmes një letre të datës 8 prill 2019, Misionit edhe njëherë iu kërkua që të jepte përgjigje ndaj pyetjeve dhe vërejtjeve me shkrim sa më parë që ishte e mundur.
10. Më 20 qershor 2019, ankuesja u informua se Paneli ende ishte në proces të shqyrtimit të ankesës së saj.
11. Vërejtjet e Misionit mbërritën më datën 21 prill 2020, dhe u përcollën më tutje nga Paneli tek ankuesja më 8 korrik 2020.
12. Më 28 korrik 2020, në Panel mbërritën komentet e ankueses rreth vërejtjeve të Misionit.
13. Më 7 gusht 2020, Paneli i përcolli komentet e ankueses tek Misioni.

II. QËNDRIMI

14. Duke e pasur parasysh raportin familjar të afërt mes viktimave parësore dhe ankueses, përkatësisht raportin mes nënës, babait dhe vajzës së tyre, Paneli pranon se ankuesja mund të konsiderohet si viktimë dytësore e shkeljeve të pretenduara dhe, si e tillë, viktimë e mundshme në pajtim me Rregullën 25(1) të Rregullores së punës së Panelit.
15. Më tej, edhe tre anëtarë të tjerë të familjes së gjerë të ankueses janë zhdukur gjatë ngjarjeve, siç është e shpjeguar në vijim. Në sqarimin e ankesës së saj, ankuesja ka cekur se ata tre anëtarë të familjes janë përmendur në ankesën e saj meqë rrethanat në të cilat ata janë zhdukur lidhen me ato në të cilat janë zhdukur prindërit e saj, por se ata tre anëtarë të familjes kanë të familjarë të gjallë më të afërt sesa ajo dhe ata duhet të kontaktohen ndaras. Andaj Paneli do ta shqyrtojë rastin vetëm në lidhje me zhdukjen e prindërve të ankueses.

III. FAKTET

16. Më 18 maj 1998 apo rreth kësaj date, shumë banorë të fshatit Leçinë ikën nga fshati për arsye të sigurisë. Prindërit e ankueses, banorë të fshatit, qëndruan në shtëpinë e tyre.
17. Më 18 maj 1998 apo rreth kësaj date, një grup i armatosur hyri në fshat dhe nëpër shtëpitë e familjeve, përfshirë edhe në shtëpinë e prindërve të ankueses, sipas një dëshmitari. Ky dëshmitar, kushëri i ankueses, kishte arritur të ikte në një mal në afërsi. Dëshmitari kishte dëgjuar britma dhe të shtëna që vinin nga shtëpia, dhe kishte parë se si grupi i armatosur i kishte djegur shtëpitë e familjes.

18. Nuk ka pasur asnjë gjurmë të prindërve të ankueses.
19. Edhe tre të afërm të tjerë më të largët të ankueses po ashtu ishin zhdukur po më atë datë apo rreth asaj date. Ata persona ishin halla e ankueses dhe djali i saj, të dy të pranishëm në fshat në kohën e ngjarjes, si dhe një kushërinë tjetër e ankueses, e cila për herë të fundit ishte parë në një pikëkontrolli të policisë serbe gjatë rrugës së saj për në fshat. Nuk ka pasur asnjë gjurmë të asnjë prej këtyre tre personave.
20. Zhdukjet ishin raportuar tek Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC), Kryqi i Kuq i Jugosllavisë dhe tek Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK). ICRC-ja dhe Kryqi i Kuq i Jugosllavisë hapën kërkesat për gjurmimin e prindërve të ankueses më 20 maj 1998 dhe 24 qershor 1998, përkatësisht.
21. Gjatë periudhës 2001-2002, ICRC dhe Shoqata e familjarëve të personave të zhdukur morën të dhëna ante-mortem nga disa familjarë për të lehtësuar gjurmimin.

IV. ANKESA

22. Ankesa i referohet në përgjithësi Deklaratës universale të të drejtave të njeriut (DUDNJ) dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të njeriut ("Konventa"). Konventa nuk i referohet ndonjë të drejte të caktuar të njeriut apo ndonjë dispozite specifike të këtyre instrumenteve.
23. Nga kuptimi i ankesës, është e qartë se ajo ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të këtyre të drejtave themelore: neni 2 i Konventës nën kreun e saj procedural, i cili garanton të drejtën themelore të një personi për të jetuar dhe parashih obligimin për të hetuar raste të vdekjeve të dyshimta; dhe, neni 3 i Konventës i cili garanton të drejtën e personit për të mos iu nënshtruar torturës apo trajtimit apo dënimit çnjerëzor apo degradues.
24. Përveç kësaj, ankesa mund të jetë relevante për nenet 8 dhe 13 të Konventës, të cilët garantojnë, përkatësisht, të drejtën e individit për jetë private dhe familjare, dhe të drejtën për mjete efektive.
25. Më tej, ankesa mund të jetë relevante për të drejta të caktuara ekonomike dhe sociale, si e drejta për siguri sociale dhe e drejta për standard adekuat të jetesës, siç përcaktohet me nenet 9 dhe 11, përkatësisht, të Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore (ICESCR), dhe me nenet 22 dhe 25, përkatësisht, të DUDNJ.

V. PARASHTRIMET E PALËVE

Ankesa

26. Ankuesja pretendon se Misioni, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, është dashur ta hetonte zhdukjen e prindërve të saj, dhe me faj nuk ka vepruar ashtu, duke u shkelur kështu të drejtat e saj të njeriut.

Misioni

27. Misioni parashtron se për këtë rast është vënë në dijeni pas dorëzimit të rasteve dhe dosjeve të rasteve nga UNMIK-u përgjatë periudhës dhjetor 2008 - mars 2009.

28. Kur u bë dorëzimi prej UNMIK-ut në EULEX në periudhën 2008-2009, rastet ë lidhje me prindërit e ankueses janë konsideruar “të hapura/joaktive” nga Njësia e UNMIK për krimet e luftës-personat e zhdukur, dhe “të mbyllura/në pritje të informatave të reja” nga NjQHHP të UNMIK. Rastet janë dorëzuar sipas marrëveshjeve mes UNMIK-ut dhe EULEX-it për dorëzimin e mbi 50 rasteve prokuroriale të klasifikuara nga UNMIK-u si “krime të luftës”, 1187 rasteve policore të klasifikuara nga UNMIK-u si “krime të luftës”, dhe rreth 5000 dosjeve të rasteve policore të klasifikuara nga UNMIK-u si “raste të personave të zhdukur”, ku këto të fundit kanë përmbajtur dosjet rreth prindërve të ankueses.
29. Misioni thekson se Njësia e EULEX për Hetimin e Krimeve të Luftës (NjHKL) mori nga Njësia e UNMIK për Krime të Luftës (NjKL) “një numër raportesh hetimore që përmbanin informata themelore rreth zhdukjes të prindërve të ankueses”, ku cekej se rastet në lidhje me zhdukjet duhej të mbaheshin “të hapura”, dhe se informatat mungonin. Përveç kësaj, NjHKL e EULEX-it mori disa dokumente të mëtejme nga vitet 2000-2001 që vinin kryesisht nga Njësia Qendrore e Hetimeve Penale (NjQHHP) e UNMIK-ut.
30. Misioni gjithashtu jep një shpjegim të gjatë rreth regjistrimit më masë të madhe, ruajtjes dhe kategorizimit të rasteve dhe dosjeve të rasteve gjatë dhe pas dorëzimit nga UNMIK-u. Misioni më tej përmend sfidat e shumta, përfshirë burimet e kufizuara dhe diskrepancat në lidhje me dosjet e rasteve, të hasura gjatë përpjekjeve për organizimin e dosjeve të rasteve. Misioni thekson se duke i pasur parasysh këto sfida, NjHKL ka prioritetizuar shqyrtimin e dosjeve të “krimeve të luftës” para dosjeve të “personave të zhdukur”. Ai më tej ka prioritetizuar dosjet e “krimeve të luftës” që janë dukur më premtuese në aspektin e gjetjeve hetimore.
31. Misioni më tej thekson se Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 nuk ka përmbajtur asnjë referim shprehimor për “zhdukjet e detyruara” në lidhje me mandatin ekzekutiv të Misionit në sistemin e drejtësisë penale atë kohë. Legjislacioni kosovar në fuqi në atë kohë i ka përcaktuar zhdukjet e detyruara si vepra që përbënin, në rrethana të caktuara, krime kundër njerëzimit, jo krime të luftës. Misioni thekson se ai megjithatë i ka hetuar dhe ndjekur penalisht instanca të zhdukjeve të detyruara në kuadër të rasteve të krimeve të luftës.
32. Sa i përket rastit aktual, Misioni në parashtrimet e veta i referohet një numri të hapave hetimorë që i ka ndërmarrë. Ata mund të përmbliidhen si në vijim:
- i. Më 18 korrik 2009, prokurori i EULEX-it ka bërë kërkesë për bërje të hetimeve në lidhje me rrëmbimin e pretenduar të prindërve të ankueses dhe të dy personave të tjerë. Misioni thekson se “[d]o të dukej se ‘kërkesa e datës 18 korrik 2009 për bërje të hetimeve’ nuk është vijuar nga NjHKL”.
 - ii. Më 18 tetor 2013, një prokuror tjetër i EULEX-it në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dha një ‘autorizim’ ku i kërkoi NjHKL që të gjenin një dëshmitar okular të ngjarjes, dhe persona të tjerë nuk kishin lidhje me viktimat e rastit aktual. Kur NjHKL veproi pas kërkesës, ajo mësoi se dëshmitari okular kishte vdekur në ndërkohë dhe ndonëse intervistat me personat e tjerë ishin mbajtur, ato nuk qojnë në zbulimin e asnjë informate të dobishme.
 - iii. Rrjedhimisht, më 2 dhjetor 2013, një prokuror i EULEX-it e hodhi poshtë kallëzimin penal sepse, “nga informatat e grumbulluara deri në atë pikë, ‘nuk kishte asnjë indikacion për atë se kush mund të ishin të dyshuarit e mundshëm dhe për provat e mundshme për t’u përdorur në procedurat penale të mëtejme.’ Në hedhjen poshtë, prokurori i EULEX-it po ashtu bëri të ditur se vendimi nuk përjashtonte ‘mundësinë e paraqitjes së një kallëzimi penal të ri nëse do të dilnin prova shtesë’ dhe se pala e dëmtuar kishte mundësinë e caktimit të një takimi me prokurorinë e EULEX-it për të diskutuar rastin nëse ajo dëshironte.

- Në hedhjen poshtë ishte përmendur vetëm një palë e dëmtuar; adresa e kësaj pale gjendej në Serbi, jashtë kufijve të Kosovës”.
- iv. Në qershor 2018, njësia prokuroriale e Misionit inicioi një kërkesë për ndihmë juridike reciproke në Serbi, përmes Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, meqë njësia vërejti se hedhja poshtë nuk i ishte komunikuar palës së dëmtuar.
 - v. Më 8 qershor 2015, EULEX-i mori nga UNMIK Opinionin e Panelit Këshillëdhënës të UNMIK për të Drejtat e Njeriut të datës 14 dhjetor 2014 për rastet 264/09 dhe 265/09, të nxjerrë pas një kërkesë të bërë nga vëllai i ankueses. Më 24 qershor 2015, Misioni e përcolli këtë Opinion tek Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës së bashku me një ftesë për vlerësimin e rastit dhe e përcolli atë tek autoritetet kompetente të ndjekjes penale.
 - vi. Më 28 qershor 2015, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e informoi EULEX-in se rasti ishte dërguar në PSRK.
33. Paneli ka pasur rastin t'i shikojë dokumentet konfidenciale në lidhje me hapat e shpjeguar në paragrafin e sipërm.
 34. Nuk ka indikacion se Misioni e ka informuar ankuesen rreth ndonjë informate në posedim të Misionit apo rreth hapave që Misioni i ka ndërmarrë në lidhje me rastin. Po ashtu nuk ka asnjë indikacion se Misioni ka bërë përpjekje për ta kontaktuar ankuesen.
 35. I pyetur nëse, për aq sa Misioni ka informata, ky rast është duke u hetuar, Misioni është përgjigjur se, në pajtim me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2018/856 të datës 8 qershor 2018 për ndryshimin e Veprimit të përbashkët 2008/124/CFSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, Misioni më nuk ka mandat për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve. Misioni nuk i është përgjigjur pyetjes së Panelit dhe, në vend të asaj, 'ka inkurajuar [ankuesen] që të kërkojë çfarëdo informate nga institucionet kompetente të Kosovës'.
 36. I pyetur nëse Misioni i ka shkelur të drejtat themelore të ankueses, Misioni sugjeron se ankuesja nuk i referohet asnjë shkelje të caktuar të të drejtave themelore nga ana e EULEX-it. Misioni, më tej, thekson se karakterizimi juridik i çështjes – sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës – është bërë nga Paneli, jo nga ankuesja.
 37. Sa i përket substancës, Misioni nuk e konteston pranueshmërinë e ankesës.
 38. Misioni duket se i adreson meritat e ankesës në parashtrimet e tij duke theksuar se “[k]ur vijmë tek meritat e ankesës që ka të bëjë me [prindërit e ankueses], EULEX-i nuk e konteston se ankuesja, si viktimë e tërthortë e shkeljeve të pretenduara, ka të drejtë për hetime efektive për zhdukjen e prindërve të saj. Megjithatë, ai pohon se njësitë e tij relevante i kanë ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për hetimin e rastit dhe nuk i kanë shkelur të drejtat e ankueses”. Misioni bën parashtrime të mëtejme siç shihet në lidhje me meritat e rastit. Paneli e thekson atë në Deklaratën e fakteve dhe pyetjeve të datës 8 dhjetor 2017 rreth pranueshmërisë së ankesës, dhe Paneli do t'i shqyrtojë parashtrimet rreth meritave të rastit ndaras në fazën e meritave.
 39. Misioni ka bërë parashtrime rreth asaj çka ai thotë është mungesa e kompetencës *ratione personae* të Panelit kur kemi të bëjmë me zhdukjen e tre personave të tjerë, anëtarë të familjes së gjerë të ankueses. Siç është theksuar në paragrafin 15 më sipër, ankuesja ka dhënë sqarime rreth çështjes në parashtrimet pasuese të saj. Rrjedhimisht, Paneli nuk ka nevojë të vlerësojë pranueshmërinë e ankesës sa i përket këtyre tre personave.

VI. VLERËSIMI I PANELIT

Mandati i Panelit (Rregulli 25 par. 1 i Rregullores së punës) dhe kufizimet e qenësishme të vëna mbi Misionin në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut

40. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të aplikojë instrumentet e të drejtave të njeriut ashtu siç është e pasqyruar në Konceptin e llogaridhënies së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Për punën e Panelit instrumentet e rëndësishme të posaçme janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat i përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike. Në punën e vet, Paneli po ashtu mund t'i referohet edhe, *inter alia*, Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
41. Para shqyrtimit të ankesës për sa i përket meritave, Paneli duhet të merr vendim rreth procedimit të ankesës, duke i pasur parasysh kriteret e përcaktuara në Rregullin 29 të Rregullores së punës.
42. Sipas Rregullit 25, paragrafi 1, Paneli mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-in Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
43. Paneli tashmë ka vërtetuar se veprimet e prokurorëve dhe policëve të EULEX-it në parim përbëjnë pjesë të mandatit ekzekutiv të Misionit dhe kështu bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *Latif Fanaj kundër EULEX*, 2016-06, 14 shtator 2011, par. 65; *K deri T kundër EULEX*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 43). Paneli nuk sheh ndonjë arsye për të devijuar nga praktika e tij gjyqësore e krijuar për rastin aktual.

A ngritën pretendime në ankesë për shkelje të të drejtave nga Misioni?

44. Si çështje preliminare, Misioni sugjeron se ankuesja nuk ngritë pretendime apo atribuon shkelje kundrejt Misionit. Ky pohim tashmë është ngritur dhe është refuzuar në një rast të mëparshëm. Ai duhet të refuzohet për po ato arsye.
45. Në vendimin e tij të pranueshmërisë për rastin e *Milijana Avramović kundër EULEX* (2016-17) të datës 11 dhjetor 2019 (<https://hrrp.eu/docs/decisions/2019-12-11%20Admissibility%20Decision%202016-17.pdf>), Paneli kishte deklaruar si në vijim (parag 47 *et seq*):
 47. Në parashtrimet e tij, ndonëse pa e kundërshtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pranueshmërinë e këtij rasti, Misioni sugjeron se ankuesja nuk ngritë asnjë pretendim specifik kundër EULEX-it dhe as që e përmend EULEX-in në ankesën e saj. Andaj Misioni 'i kërkon Panelit që të bëjë një vlerësim nëse rasti 2016-17 mund të konsiderohet si ankesë kundër Misionit dhe të mos trajtohet ndryshe si kërkesë e thjeshtë dhe legjitime për informata rreth statusit të hetimeve'.
 48. Kriteret sa i përket formës dhe substancës për rregullimin e përmbajtjes së ankesës para Panelit janë të përcaktuara në Rregulloren e punës së Panelit (shih rregullin 25 dhe më tutje). E vlerësuar kundrejt këtyre rregullave, Misioni nuk sugjeron se ankesa përmban ndonjë të metë formale që do të ndikonte mbi pranueshmërinë e rastit.

49. Në lidhje me pyetjen e natyrës së ankesës dhe nëse ajo ka të bëjë me aktet që mund t'i atribuohen Misionit, Paneli do të theksonte si në vijim. Së pari, në pajtim me Rregulloren e punës (dhe planin operacional OPLAN), Paneli ka kompetencë që të vlerësojë vetëm ankesa për shkelje të të drejtave *kundër Misionit*. Rregulli 25, paragrafi 1, i Rregullores së punës së Panelit përcakton se '[a]nkesa mund të parashtrohet nga çdo person që nuk është staf i EULEX-in Kosovë i cili pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-in Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv'. Në atë kuptim, parashtimi i ankesës para Panelit duhet per force dhe mund t'i përket vetëm një pretendimi për shkeljen e të drejtave që thuhet se mund t'i atribuohen Misionit.
50. Së dyti, lidhur me substancën e ankesës, siç është e dukshme nga forma e ankesës e përdorur nga kjo ankuese dhe ankues të tjerë, të gjitha ankesat para Panelit përmbajnë pretendime për shkelje të të drejtave (shin formën e ankesës, shkronja B) që i atribuohen, sipas formës së ankesës, EULEX-it (shih formën e ankesës, pika V). Andaj ankesa është ankesë e rregullt për shkelje të të drejtave e parashtuar kundër Misionit.
46. Këto konstatime vlejné *mutatis mutandis* për rastin aktual dhe i përgjigjen parashtimeve të Misionit. Andaj Paneli është i bindur se ankesa i përmbushë kriteret e formës dhe substancës të cilat kërkohen në kuadër të rregullave dhe është i bindur se ankuesja në fakt pretendon se Misioni i ka shkelur të drejtat e saj.
47. Misioni gjithashtu ka parashtuar se faktet dhe pyetjet e dorëzuara nga Paneli tek Misioni nuk kanë qenë juridikisht të shëndosha meqë ato kanë sugjeruar se ankuesja i ishte referuar shkeljes së ë drejtave të caktuara ndërsa në fakt ka qenë Paneli ai i cili i ka karakterizuar faktet e pretenduara sipas normave juridike të caktuara. Misioni duket se e keqkupton rolin e Panelit: cilat norma vlejné për ndonjë rast të caktuar është përgjegjësi e vet Panelit (*juranovit curia*), dhe Paneli nuk obligohet nga mënyra në të cilën cilado palë i karakterizon faktet e rastit nga pikëpamja juridike. Fakti se forma e ankesës para Panelit e përmban një pjesë në të cilën ankuesja mund të thërret instrumente apo dispozita specifike të të drejtave të njeriut nuk e ndryshon rolin dhe përgjegjësinë e Panelit për karakterizimin juridik të rastit.
48. Më tej, Paneli do të theksonte se një numër i madh i ankuesve nuk janë të trajnuar për çështje juridike dhe vinë para Panelit pa përfaqësime që Paneli duhet të sigurojë që baza mbi të cilën Paneli i nxjerr vendimet e veta të pasqyrojë me saktësi faktet e rastit edhe nëse njëra apo tjetra palë nuk i ka artikuluar ato plotësisht apo në mënyrën e duhur.
49. Paneli gjithashtu thekson se parimi i *juranovit curia* është i themeluar mirë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shih p.sh. *Şerife Yiğit v. Turqia [GC]*, nr. 3976/05, Aktgjykimi i datës 2 nëntor 2010, par. 52, ku Gjykata ka theksuar:
- “[M]eqë Gjykata është mjeshtre e karakterizimit që duhet t'i jepet në të drejtën për faktet e rastit, ajo nuk obligohet prej karakterizimit të dhënë nga aplikuesi apo qeveria. Duke u mbështetur në parimin *juranovit curia*, ajo, për shembull, ka konsideruar si të vetat ankesat kërkesat sipas neneve apo paragrafëve në të cilat palët nuk janë bazuar si dhe sipas një dispozite sipas së cilës gjykata e ka shpallur ankesën ë papranueshme ndërsa e ka shpallur atë të pranueshme sipas një tjetre. Ankesa karakterizohet me faktet e pretenduara aty dhe jo thjesht nga bazat apo argumentimet juridike në të cilat është bazuar [...]”
50. Në këtë rast të caktuar, është e qartë, nga natyra e pretendimeve faktike që gjenden në ankesë – siç ka ndodhur në një numër të madh të ankesave të mëparshme të ngjashme

– se të drejtat themelore relevante për këtë ankesë janë ato që janë të garantuara, *inter alia*, në nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës.

51. Paneli po ashtu thekson, si pikë e përgjithshme, se zhdukjet e detyruara mund të prekin të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të viktimave parësore dhe dytësore, përveç të drejtave të tyre civile dhe politike. Ekziston një gamë e gjerë e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të njohura me DUDNJ dhe MNDESC të cilat mund të preken nga zhdukja e detyruar, nga të drejtat për shëndet dhe arsim, deri tek të drejtat për siguri sociale, pronë dhe banim.
52. Grupi punues për zhdukjet e detyruara apo të pavullnetshme ka vënë re, sa i përket vuajtjes së shkaktuar nga zhdukjet e detyruara mbi të afërmit e atyre që janë zhdukur në mënyrë të detyruar, se “tronditjet emocionale përkeqësohen nga privimi material” (shih *Komentin e përgjithshëm për gratë e prekura nga zhdukjet e detyruara* i miratuar nga grupi punues për zhdukjet e detyruara apo të pavullnetshme në sesionin e tij të nëntëdhjetë e tetë, A/HRC/WGEID/98/2, par. 12). Një rrethanë në të cilën mund të ketë ndikim mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore është kur personi i zhdukur e ka mbajtur financiarisht familjen, apo ka qenë titullar juridik i pasurisë apo pronës së familjes, apo pretendim për përfitime apo pagesa të caktuara. Një hetim efektiv i zhdukjes mund të ketë pasojën e drejtpërdrejtë për vërtetimin e ekzistencës apo vdekjes juridike të personit të zhdukur, dhe kështu titulli i pronës dhe qasja për mbështetje që familjarët mund të kërkojnë (shih *raportin e grupit punues për zhdukjet e detyruara apo të pavullnetshme, shtojca, studimi për zhdukjet e detyruara apo të pavullnetshme dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*, A/HRC/30/38/Add.5, par. 25-27).
53. Sa i përket karakterizimit juridik sipas të drejtave të Konventës si më lartë, ankuesja nuk ka bërë ndonjë pretendim specifik sa i përket të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Rrethanat e rastit, përkatësisht lidhja mes ankueses (vajza) dhe viktimave parësore (prindërit e ankueses), megjithatë e drejtojnë Panelin që të kërkojë informata të mëtejme nga ankuesja në këtë drejtim.
54. Andaj Misioni do të ftohet që të adresojë substancën e secilës së drejtë themelore që mund të jetë potencialisht relevante për ankesën aktuale, siç është theksuar më lart.

Konsiderime të ndryshme

55. Siç është theksuar më lart, si përgjigje për disa prej pyetjeve të Panelit, Misioni ka sugjeruar se ankuesja duhet t'i drejtojë ato pyetje tek autoritetet e vendit.
56. Paneli dëshiron ta bëjë të qartë se qëllimi i këtyre procedurave nuk është që ankuesen ta drejtojnë tek ndonjë palë e tretë. Në pajtim me rregulloren e punës së Panelit, qëllimi i procedurave është verifikimi i pajtueshmërisë së Misionit me detyrimet e veta si bartës i detyrës për të drejtat e njeriut i obliguar nga e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Deri në masën që hapat duhet të ndërmerren për atë qëllim, është përgjegjësi e Misionit që të ndërmerr hapa në lidhje me autoritetet e vendit. Paneli gjithashtu e fton Misionin që të heq dorë nga parashtrime të ngjashme në procedura të ardhshme.
57. Aty ku janë ndërmarrë, këta hapa mund të jenë relevantë për vlerësimin e Panelit sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së reagimit të Misionit në drejtim të të drejtave të njeriut që janë nën shqyrtim. Andaj Paneli e fton Misionin që si pjesë e parashtrimeve të tij rreth meritave të rastit të tregojë se çfarë hapash, nëse është ndërmarrë ndonjë, ka ndërmarrë Misioni për ta diskutuar dhe ngritur çështjen aktuale me autoritetet e vendit.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

E SHPALLË TË PRANUESHME, pa paragjykuar meritat e lëndës, ankesën sa i përket shkeljes së pretenduar të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe neneve 9 dhe 11 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;

E FTON MISIONIN që në parashtrimet e tij sa i përket meritave të këtij rasti që sqarojë çështjet në vijim:

- i. Çfarë parashtrime dëshiron të bëjë Misioni në lidhje me substancën e të drejtave të njeriut të cekura më lart?
- ii. Çfarë hapa, nëse është ndërmarrë ndonjë, janë ndërmarrë nga Misioni drejt autoriteteve të vendit në lidhje me këtë rast? Në veçanti, a ka pyetur Misioni tek autoritetet e vendit nëse (a) ato kanë qenë në dijeni për ekzistimin e rastit dhe (b) nëse ato janë duke e hetuar atë, dhe nëse jo, (c) përse.
- iii. Çfarë roli, nëse ka ndonjë, ka për qëllim të ketë Misioni në të ardhshme në lidhje me këtë rast të pazgjidhur të zhdukjes së detyruar? Çfarë mase apo veprim konkret e konsideron Misioni në kuadër të kompetencave të tij (aktuale) për të kërkuar avancimin e hetimeve dhe zgjedhjen e këtij rasti? Nëse Misioni nuk ka për qëllim të ndërmerret ndonjë hap në lidhje me këtë rast, përse ashtu?
- iv. A i janë dërguar dokumentet rreth këtij rasti autoriteteve kosovare pas ndryshimit të mandatit të Misionit në qershor 2018 dhe pas zvogëlimit të kompetencës ekzekutive?
- v. A ka bërë përpjekje Misioni që t'i identifikojë familjarët, përfshirë fëmijët e gjallë, të personave të zhdukur në rastin aktual, përveç familjarëve të identifikuar në parashtrimet e Misionit dhe dokumentet konfidenciale të ndërlidhura? Nëse jo, përse?
- vi. A ka bërë përpjekje Misioni që të kontaktojë ankuesen apo familjarët e prindërve të zhdukur të ankueses përtej hapave të përmendur në parashtrimin e Misionit dhe dokumenteve konfidenciale të ndërlidhura? Nëse jo, përse?

Gjatë adresimit të çështjeve të sipërpërmendura, Paneli e fton Misionin që të mos i rithekson parashtrimet që tashmë janë bërë dhe janë refuzuar si jomeritore në raste të mëparshme.

E FTON ANKUESEN që të përgjigjet në çështjet në vijim:

- i. Ju lutemi të shpjegoni mbështetjen apo ndihmën apo banimin që prindërit tuaj kanë siguruar për juve dhe familjen tuaj para zhdukjes së tyre.
- ii. Ju lutemi të shpjegoni ndikimet personale dhe emocionale që zhdukja e prindërve tuaj ka pasur mbi juve dhe familjen tuaj.
- iii. Ju lutemi të shpjegoni ndikimet juridike dhe financiare që zhdukja e prindërve tuaj ka pasur mbi juve dhe familjen tuaj. Po ashtu shpjegoni ndonjë pengesë apo vështirësi që mund të jeni përjetuar si rezultat i asaj që prindërit tuaj vazhdojnë të jenë të zhdukur, gjatë kërimit të qasjes në ndonjë mbështetje, pagesë apo titull juridik, si ato të cekura në pyetjet më poshtë. Për shembull:

- a. A keni pasur qasje të plotë, të pjesshme apo fare në ndonjë përfitim, pagë, pension, asistencë sociale dhe llogari bankare që prindërit tuaj i kanë gëzuar apo do t'i kishin gëzuar?
- b. A keni trashëguar titullin juridik në ndonjë pronë, përfshirë banim, që prindërit tuaj mund të kenë pasur?
- c. A keni pasur shpenzime financiare si rezultat i zhdukjes së prindërve tuaj që nuk janë kompensuar?

DHE U KËRKON palëve që të përgjigjen në pyetjet e sipërme dhe të paraqesin ndonjë parashtrim tjetër rreth meritës së këtij rasti më së largu deri më 28 shkurt 2021.

Për Panelin,

Guénaël Mettraux
Kryesues

Anna Bednarek
Anëtare

Anna Autio
Anëtare